



Trajneri i Drenices Fadil Rama ka dhene sot doreheqjen nga drejtimi i skuadres. Kete fakt e ka konfirmuar edhe kryestari i klubit nga Skenderaj Iliaz Halili. "Pas rezultateve te dobeta ne kete fillim sezoni te skuadres sone, kryetrajneri Fadil Rama ka vendosur qe te japi doreheqjen nga drejtimi i skuadres", ka thene Halili.

Tahir Lushtaku i cili e ka drejtuar ekipin sezonin e kaluar, eshte njeri prej trajnereve kandidate per te marre postin drejtues te skuadres.

Pas pese ndeshjesh ne Raiffeisen Superliga te Kosoves, Drenica ka fituar vetem nje ndeshje dhe ka humbur kater duke u renditur e fundit ne tabelen e klasifikimit me 3 pike